

© 2019 Suela Koreta.

This is an open access article licensed under the Creative Commons Attribution-Non-Commercial NoDerivs License ([Creative Commons Attribution 4.0 International License](https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/))

TERMINOLOGJIA E FONETIKËS

Suela KORETA

University College "Reald, Albania
suela.korata@unireald.edu.al

Abstract

The terminology of phonetics, in the complete terminological lexicon of Albanian, constitutes a stable and homogeneous lexical system, which is prominently distinguished from the lexical units themselves, characteristic for this system, which identify this field of knowledge from other fields, such as it can be easily understood that we are dealing with this special science also from terms such as: sound, vowel, consonant, noun, verb, phrase, sentence.

However, the lexical terminological system of linguistics is divided into separate subsystems, which have their own characteristics from the point of view of the units that make them up. They can be identified as representative of specific subsystems even when used within a text with themes from the field of linguistics, in general, as: noun, adjective, verb (from the field of morphology); phrases, sentences (from the field of syntax); vowels, consonants (from the field of phonetics), although there are also intermediate fields, such as morphology, word formation, etc., but which are distinguished in themselves for a mixed terminology.

Thus, e.g. morphology, perhaps with the exception of the term morphonema and any other, consists of the terms phonetics (phonology) and morphology. The same can be said for word formation, where terms such as: prefix, suffix, (from the word formation itself) meet within a text; words, meaning (from lexicology); noun, adjective (from morphology) etc. This means that each of the terminologies of these fields can become a separate object of study, as they represent certain subsystems from the point of view of their lexical composition.

Key words: *terminology, phonetics, construction, subsystem, text, word formation*

Abstrakt

Terminologjia e fonetikës, në leksikon terminologjik tërësor të shqipes, përbën një sistem leksikor të qëndrueshëm dhe homogjen, që dallohet në mënyrë të spikatur nga vetë njësitë leksikore, karakteristike për këtë sistem, të cilat e identifikojnë këtë fushë të dijes nga fushat e tjera, siç mund të kuptohet lehtë se kemi të bëjmë me këtë shkencë të veçantë edhe nga termat, si: tingull, zanore, bashkëtingëllore, emër, folje, togfjalësh, fjali...

Megjithatë edhe sistemi leksikor terminologjik i gjuhësisë ndahet në nënsisteme të veçanta, që kanë veçoritë e tyre nga pikëpamja e njësisë që i përbëjnë. Mund të identifikohen si përfaqësuese të nënsistemeve të veçanta edhe kur përdoren brenda një teksti me tematikë nga fusha e gjuhësisë, në përgjithësi, si: emër, mbiemër, folje (nga fusha e morfologjisë); togfjalësh, fjali (nga fusha e sintaksës); zanore, bashkëtingëllore (nga fusha e fonetikës), ndonëse ka edhe fusha të ndërmjetme, si: morfonologjia, fjalëformimi etj., por që dallohen në vetvete për një terminologji të përzier.

Kështu, p.sh. morfonologjia, ndoshta me përjashtim të termit morfonemë e ndonjë tjetër, përbëhet nga terma të fonetikës (fonologjisë) dhe të morfologjisë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për fjalëformimin, ku takohen brenda një teksti termat, si: parashtesa, prapashtesa, (nga vetë fjalëformimi); fjalë, kuptim (nga leksikologjia); emër, mbiemër (nga morfologjia) etj. Kjo do të thotë që secila nga terminologjitë e këtyre fushave mund të bëhet objekt i veçantë studimi, meqë përfaqësojnë nënsisteme të caktuara nga pikëpamja e përbërjes leksikore të tyre.

Fjalët kyçe: *terminologji, fonetikë, ndërtim, nënsistem, tekst,*

1. HYRJE

Terminologjia e fonetikës krahas fushave të tjera të gjuhësisë është zhvilluar në mënyrë të përshkallëzuar deri në ditët e sotme, duke filluar qysh nga termat e koncepteve bazë të saj, si: tingull, zanore, bashkëtingëllore e deri te termat më specifike, si: zanore mbylltore e shurdhët, zanore themelore e ngritjes së lartë etj. Në gramatikat e para të botuara, ndonëse në mënyrë të kufizuar, në pak faqe gjejmë material edhe për nga fusha e fonetikës, e cila është një ndër disiplinat bazë të gjuhësisë.

Terminologjia e fonetikës fillimisht ka shërbyer për nevojat e shkollave shqipe të nivelit të ulët që sapo fillonin të futeshin në vendin tonë. Kjo kushtëzohej nga përpjekjet e para për sjelljen edhe në gjuhën shqipe të elementeve të para fillestare shkencore, siç nënvizon prof. Xh. Lloshi: “Përpjekjet e para të shkencës shqipe janë bërë në fushat e shkencave dhe fjalorët e parë të shqipes përfshihen në vazhden e përpunimit të stilit dituror.

Rilindja Kombëtare i dha një shtysë të fuqishme përpunimit të mendimit shkencor për shqiptarët dhe Shqipërinë dhe, më pas, këtë shtysë e çoi më tej paraqitja

e dijeve fillestare për shkollën”.¹

Kjo gjë mund të thuhet edhe për dijet fillestare edhe nga fusha e fonetikës, për të cilën filloi të krijohej terminologjia përkatëse, ndonëse në nivel të ulët. Ndiheja e N. Veqilharxhit do të përmendej për një grup termash, si ëvetar, ëvet, zëtore (zantore), mezëtore etj., shpjegimi i të cilave ka qenë në dritën e studimeve të gjuhëtarëve tanë.²

E. Çabej thotë se termi “*ëvetar*”, përdorur nga n. Veqilharxhi, është frymëzuar nga fjala greke, po jo si në greqishte, po me shkronjën ë, që te Kristoforidhi del abetar - idhe te S. Frashëri del abetare – ja. Fjala “*ëvetar* është e afërt me fjalën greke, po jo e njëjtë me të nga përdorimi.

N. Veqilharxhi shkronjat i quan ëvet, si ëvet e dorës, ëvet e vogla (të mëdha) etj. Pra, ëvetar duhet kuptuar: ëve + prapashtesë (tar), ajo e shkronjave, libri i shkronjave apo shkronjëtores (S. Frashëri). Ëvet e mëdha i quan edhe kreretore (kryeradhë). Terma të tjerë të fonetikës së ligjërimin nga N. Veqilharxhi na vijnë: zëtore e mezëtore, e afërt me greken. Këto dy terma i gjejmë edhe te Gramatika e J. Vretos, rreth 20 vjet më pas.

Siç duket, të dy janë mbështetur apo janë nisur nga e njëjta bazë, pra nga termat e greqishtes e të shqipëruara.

Termi zanore është një me zëtoren e N. Veqilharxhit, e krijuar nga K. Kristoforidhi (1872). Madje, që te N. Veqilharxhi gjejmë edhe trajtën zantore (1869). Termat e zëshme, e pazëshme N. Veqilharxhi i jep si variante të dyta për zëtore e mezëtore. Një rëndësi të veçantë merr vepra e S. Frashërit, në të cilën gjejmë fillimet e bazave të fonetikës. Për morfologjinë mund të thuhet se janë hedhur bazat e saj qysh nga ajo kohë, kurse për terminologjinë e fonetikës mund të themi se në këtë vepër vihen re filletat e bazave të kësaj terminologjie. Në këtë vepër gjuhësore kemi një numër të kufizuar termash të fushës së terminologjisë së fonetikës nga ana sasiore e më vonë vihet re një rritje e dukshme e saj. Në botimet e mëvonshme të ndryshme nga fusha e fonetikës, kryesisht tekste mësimore, gjejmë një numër të konsiderueshëm termash, kryesisht terma togfjalësh, terma njëfjalësh me një denduri të lartë përdorimi dhe shprehje terminologjike.

Sasia e kufizuar e termave në fazën e parë të zhvillimit të terminologjisë së fonetikës kushëzohej dhe lidhej me hapjen e shkollave të para shqipe të ciklit të ulët për të dhënë njohuri elementare. P.sh. te S. Frashëri³ kemi rreth 3-4 faqe, në të cilat jepen njohuri nga fushat e fonetikës (fq. 97-100). Pra, për nga sasia mund të themi se kemi relativisht terma të pakët në numër, 28 me gjithë termat togfjalësh, kurse te A. Xhuvani, nga qëmtimi i materialit të 12 . vet janë gjetur rreth 14 terma të fonetikës. Edhe pse të pakët nga ana sasiore, mund të themi se janë ndër termat bazë të terminologjisë si fonetikës.

Një pjesë nuk kanë patur më përdorim, disa të tjerë po.P.sh. nga S. Frashëri hasen

¹ Xh.Lloshi, “Stilistika dhe pragmatika”, Tiranë, 2006

² E. Lafe, Ndiheja e N. Veqilharxhit në terminologjinë shqipe, në Sf. 1986, 4, fq. 175

L. Dodbiba, Zhvillimi i terminologjisë së gjuhës shqipe, në Konferenca gjuhësore e studimeve albanologjike, 1961 (botim 1965).

³ S. Frashëri, shih 5 shoqërore: gramatikat,

termat: (zanore, bashkëtingëllore), të zëshme, të përzëshme; buzëtore (për buzore); dhëmbëtore (për dhëmbore); grykëtore (grykore); qiellëtore (për qiellzore); të ngurrëta (të zëshme); të çkrifëta (për të shurdhëta); të trasha (të prapme); të holla (të përparme); e gjatë (theksi); fishëllore (fishkëllore) etj.

Në qoftë se krahasojmë leksikon terminologjik të fonetikës të krijuar nga S. Frashëri me gjendjen e sotme, mund të shohim se nga 28 terma të regjistruar gjithsej, duke përfshirë edhe shenjat e pikësimit, sot përdoren rreth 20. Këtu nuk mbahet parasysh forma e shkrimit dhe e shqiptimit të tyre nga koha e S. Frashërit, por paraqitja e tyre e përfaqëson gjendjen e sotme. Si të tillë do të pranohen, fjala vjen, termat pyetës (sot pikëpyetje); çuditës (pikëçuditje); pikatë (sot shumëpikësh-i) etj.

Nëse marrim parasysh format e përdorura nga S. Frashëri në format e plota të sotme, atëherë themi se nga 28 terma, 11 prej tyre përpunohen plotësisht. Këtu futen rrokje shkronjë, njërrrokësh-e(s/sh), dyrrrokëshe, shumërrrokësh - e; zë, e zëshme; rrokje e fundit, pikë, presje, pikëpresje. Nga A. Xhuvani⁴ takohen termat zanore, bashkëtingëllore, dyzanor -i, të nxjerrme të zanit, thekës, thekës hunduer, të damit e rrokjeve etj.

Është e rëndësishme të nënvizohet se për herë të parë te Xhuvani bëhet diferencimi i disa nocioneve bazë të fonetikës, si tingull dhe shkronjë, si dhe futet nocioni “dyzanor -i” (për diftongun). Ndonëse edhe më vonë janë botuar disa tekste mësimore për një nivel më të lartë arsimor, prapëseprapë nuk vihet re ndonjë shtim i madh i sasisë së termave të fonetikës. Përmendim këtu se te “Gramatika e gjuhës shqipe”, K. Cipo, “Morfolgjia e sindaksa” Ilia D. Sheperi takohen disa terma të rinj, si: diftong fundor-e. Këtu hasim një terminologji me interes të veçantë studimi. Këto terma edhe pse të pakët në numër, janë të një cilësie të veçantë, janë ndër termat bazë të përdorur në terminologjinë e fonetikës, që janë ruajtur edhe sot. P.sh.: theks, zanore, bashkëtingëllore, tingull (kumbim); diftong, zanore fundore, formimi i zanoreve, bashkëtingëllore dhëmbëzore, zerore (a zanorore); bashkëzërore; dyzanor (diftong). Këtu vihet re synimi për të patur terma shqip (të shqipëruar) p.sh. dyzanor -i (për diftong).

Nivel te ri zhvillimi shënon terminologjia e fonetikes me futjen e fonetikës në shkallat e larta, si edhe të përfshirjes së fonologjisë si pjesë e fonetikës. Kjo solli edhe një shtim disi të mirë të termave për nga masa sasiore, megjithëse, në përgjithësi, përdoren të njëjtat terma bazë të formuar një pjesë qysh nga S. Frashëri, A. Xhuvani, I. D. Sheperi e K. Cipo.

Krahas termave njëfjalësh, janë formuar edhe mjaft terma togfjalësh, si edhe shprehje terminologjike. Këto të fundit, ndonëse të pakta në numër, paraqesin një interes të veçantë në fushën e terminologjisë së fonetikës.

Me futjen e koncepteve të reja shkencore, sidomos nga fusha e fonologjisë, shtohet në masë konsiderueshme nga ana sasiore dhe cilësore leksiku terminologjik i fonetikës. Kjo kushtëzohet edhe me veçimin e fonetikës si lëndë më vete dhe futja në masë e termave nga

⁴ A. Xhuvani, “Libri I gjuhës a gramatikë”, pjesa I, Elbasan, 1919.

fusha e fonologjisë, që e pasuron së tepërmi terminologjinë e fonetikës, si: formant, buzorëzim, çifte bashkëlidhëse, çifte mungesore, kundërvënie mungesore, zanore e rëndë, zanore e mprehtë, zanore e bemolizuar, kundërvënie binare etj.

Mund të nënvizohet se në veprat e para gjuhësore, duke filluar me S. Frashëri e më tej me K. Cipun, A. Xhuvanin e I. D. Sheperin, vihet re një terminologji shqipe, termat ishin kryesisht shqip e ndonjëherë, në kllapa, shënohej krahas tij termi në gjuhë të huaj. Me kalimin e kohës në tekstet mësimore të shkollave të larta e futja e studimeve të mirëfillta shkencore krahas termave shqip, janë përdorur jo rrallë edhe terma të huaj, megjithëse mbizotërojnë termat shqip dhe kjo kushtëzohet kryesisht me punën e bërë nga S. Frashëri, A. Xhuvani për krijimin e termave themelore të fonetikës me brumin e shqipes dhe me mjetet e saj fjalëformuese.

Me gjithë futjen më vonë, sidomos në tekstet e shkollave të larta të termave të huaj, ata nuk mund ta shtrembëronin fizionominë shqipe të terminologjisë së fonetikës. Termat shqip përbëjnë terminologjinë bazë të saj dhe, si të tillë, kanë në çdo tekst denduri të lartë përdorimi.

2. NDËRTIMI I TERMINOLOGJISË

Terminologjia e fonetikës është ndërtuar mbi bazën e po atyre rrugëve termformuese, të cilat janë karakteristike për çdo terminologji, ndonëse me ndonjë veçori spërcifikë, që lidhet kryesisht me shkallën e prodhimitarisë së mënyrave e mjeteve të formimit të termave. Kështu, p.sh., ndërsa ka një varg parashtesash me të cilat janë formuar terma të ndryshëm, si: pa-, jo-, pas-, ndër- etj., me anë të tyre, brenda terminologjisë së fonetikës, janë ndërtuar një numër i kufizuar termash, si: ndërthëmbor –e, patheksuar (i, e) etj. Po kështu, p.sh. takohen në raste të rralla terma kompozita si: rrokjeformues –e, drejtshqiptim e ndonjë tjetër. Në të kundërt me këto mënyra fjalëformuese, prapashtesimi është më prodhimitar, ndonëse aktivizohen një numër i kufizuar prapashtesash. Megjithatë, sikurse edhe në çdo terminologji, duhet nënvizuar se rruga sintaksore, d.m.th. ndërtimet togfjalëshore zënë vendin kryesor në këtë terminologji.

Përsa i përket rrugës semantike mund të nënvizohet se ajo, gjithashtu, është shumë e kufizuar dhe mund të paraqitet më tepër në formën e huazimeve nga fushat e tjera të dijes ose edhe nga leksiku i gjuhës së përgjithshme, ku, si veçori është se termat apo fjalët e huazuara ose përdoren në të njëjtat kuptime që kanë patur si: dhëmb, gojë, qiellzë, njerith (anatomia), timbër, rezonancë (fizikë), ose shërbejnë për të krijuar terma brenda fushës, si: dhëmbor –e, qiellzor –e etj. Megjithatë mund të ketë raste termash që mund të shihen si të ardhura nga fjalë të rikuptimësuar, si: tingull, shteg e ndonjë tjetër.

3. RRUGËT E NDËRTIMIT TË TERMINOLOGJISË SË FONETIKËS

3.1. Rruga Semantike

Termtat me formë të njëjtë, sikurse përdoren si fjalë ose si terma në fusha të tjera, nuk janë në sasi të madhe, por ata janë të rëndësishëm për dy arsye: së pari, sepse kanë denduri të

lartë përdorimi, pra, si të tillë, janë termat bazë dhe, së dyti, shërbejnë si bazë për formimin e termave të tjerë Brenda fushës, siç përmendëm më sipër, tingull, buzë etj. Duke u nisur nga ky fakt, mund të thuhet se këta terma, duke patur formë të njëjtë me termat dhe fjalët nga vijnë, shërbejnë si urë ndërlidhëse ndërmjet kësaj terminologjie dhe terminologjive të tjera, si edhe leksikut të gjuhës së përgjithshme.

Nga pikëpamja e shkallës së ndryshme të kuptimit të tyre fillestar me kuptimin që marrin brenda fushës së fonetikës ku përdoren këta terma, mund t'i ndanim në tri kategori:

1. Terma të ngritur mbi bazën e fjalëve të zakonshme ose të termave të fushave të tjera, por me kuptime pak a shumë të ndryshme në fushën e fonetikës, si: tingull, shteg, zë, zhurmë e ndonjë tjetër. Numri i tyre është i kufizuar, po denduria e përdorimit është e lartë.
2. Elemente termash me kuptime pak a shumë të ndryshuara, por qëshërbejnë si bazë për formimin e termave togfjalësh, si: i lartë, i ulët, i madh, i vogël, i mprehtë, i rëndë (ton); kryesor, i mprehtë (theks); e madhe, e vogël (shkronjë) etj.
3. Terma të ardhur nga fusha të tjera të dijes, kryesisht nga anatomia, fizika e ndonjë tjetër, si: dhëmb, buzë, timbër, rezonancë etj. Siç u tha më sipër, këto kanë denduri të lartë përdorimi dhe shërbejnë si bazë për terma të tjerë, si ndërtime brenda fushës, për të cilën kemi folur më lart.

Ndonëse rruga nëpërmjet së cilës kanë kaluar këta terma nuk është në të gjitha rastet semantike, prapëseprapë ata përdoren brenda fushës së re deri diku të specifikuar, pra, gjithsesi, me një farë ndryshimi semantic pak a shumë të theksuar, pak të theksuar ose pothuajse të njëjtë

3.2.Rruga morfologjike

Termtat krijohen nga fjalë të leksikut të përgjithshëm duke shfrytëzuar po ato mënyra dhe mjete fjalëformuese që zotëron gjuha. Këta janë terma që janë formuar brenda fushës së fonetikës, p.sh.:qiellzor-e (qiellz/ë + or-e); dhëmbor-e (dhëmb + or-e) etj., të cilët vijnë nga pjesë të ndryshme të ligjëratës, kryesisht emra, mbiemra dhe folje.

3.3.Parashtesimi

Duke u bazuar në materialin e marrë për shqyrtim, mund të vërehet se numri i parashtesave që përdoren për formimin e termave në terminologjinë e fonetikës, është përgjithësisht i vogël. Kështu hasen kryesisht parashtesat që formojnë mbiemra si elemente të termit e, rrallë, emra: pa-, jo-.takohen edhe parashtesa të tjera, si: ndër-, para-, prapa-, për-, pas-. Formime të tilla parashtesore I gjejmë qysh te S. Frashëri e më tej te Sheperi. P.sh.(zërore) të ndërgojëta, (rrokje) e parafundme,(zanore) të përparme,jofundore, (bashkëtingëllore) jopalatale, prapagjuhore etj. Elementet e termave të formuara me parashtesim janë kryesisht formime brenda fushës së fonetikës dhe përdoren në terminologjinë

e fonetikës, por ka edhe terma apo elemente termash që përdoren në leksikun e përgjithshëm ose në terminologjitë e fushave të tjera. Krahas parashtesave shqip hyjnë edhe parashtesa të huaja, si: in- që ka përgjegjëse shqip jo-; pre- përkatësisht para-; post- përkatësisht prapa-; p.sh.:(tingull) in-organik, pre-palatale, post-palatale etj.

3.4.Prapashtesimi

Formimet terminologjike në prapashtesa takohen më shpesh në terminologjitë e fonetikës, megjithatë jo në të gjitha rastet kemi të bëjmë me formime brenda fushës. Një pjesë prej tyre janë formime të ndërtuara me prapashtesa në fushën nga kanë ardhur, kështu që nuk mund të quhen ndërtime brenda fushës, por shërbejnë si bazë për formimet terminologjike brenda saj, si: kryesor-e, (krye + (s)or), zbritës-e (zbritur + ës) që krijojnë theks kryesor, theks zbritës etj.

Prapashtesat më prodhimtare janë: -or, -shëm/shme, -ës p.sh. –or: tingullor, hundor-e, buzor-e, (ton), (pozicion) fundor, qiellzor-e, prapagjuhor-e, dhëmbor-e, grykor-e, gojor-e, ndër dhëmbor-e, kulmor-e, rrënjor-e etj. Kryesisht janë formime prejëmërore dhe më tepër janë elemente termash sesa terma të mirëfilltë.

Me këtë prapashtesë janë formuar kryesisht mbiemra të panyjshëm: (zanore) hundore, (bashkëtingëllore) dhëmbore, (tinguj) kulmorë etj.-im: njëfjalësim, tingullformim, nyjëtim-shëm/shme: të zëshme, të pazëshme, i pjesshëmJanë formuar kryesisht mbiemra të nyjshshëm -ës-e: dridhës-e, shushuritës-e, ngjites-e, zbritës-e -ësi-a: hundorësi-a, buzorësi-a (terma emërorë) -ues-e: rrokjeformues-e-sor: njëanësor-e (tingull)-tar: (tingull) kalimtar (mbiemër) -tor-e: mbylltor-e (mbiemër)Ka edhe formime të veçuara me ndonjë prapashtesë të veçantë, si: -th: shtegth, njerith.

Duhet nënvizuar se me anë të prapashtesave shqipe janë shqipëruar një varg termash të huaj, të cilët janë përdorur dikur, por sot nuk përdoren më ose përdoren rrallë. Kjo ka ndihmuar për t'i dhënë kësaj terminologjie një fizionomi sa më shqipe. Formime të tilla me brumin e shqipes dhe mjetet e saj fjalëformuese e bëjnë terminologjinë e kësaj fushe më të kuptueshme e më homogjene dhe më simetrike nga ana e lidhjes së koncepteve.

Më poshtë po sjellim një listë termash në të dyja format, të huaj dhe të shqipëruar me anën e prapashtesave shqipe. Numri i tyre është i madh.

labialitet – buzorësi

- | | |
|-------------|--------------|
| ➤ labial | ➤ buzor |
| ➤ dental | ➤ dhëmbor |
| ➤ okluziv | ➤ mbylltor |
| ➤ sonant | ➤ tingëllues |
| ➤ frikative | ➤ shtegor |
| ➤ nazal | ➤ hundor |
| ➤ nazalitet | ➤ hundorësi |

➤ afrikative

➤ fërkimor

3.5.Kompozimi

Formimi i termave me anë të kompozimit është mjaft i kufizuar në terminologjinë e fonetikës dhe mund të takohen terma si raste të veçara. Formimet me kompozita mund t'i ndajmë në tri grupe kryesore:

1. Terma të mirëfilltë të krijuar brenda fushës. Sasia e tyre është shumë e kufizuar, por denduria e përdorimit të tyre, sipas tematikës që studiohet, është shumë e lartë, si: bashkëtingëllore, drejtshkrim, drejtshqiptim. Nga pikëpamja e ndarjes formale të elementeve përbërëse mund të shihet se përbëhen nga ndajfolje + emër, kurse nga mënyra e motivimit me temën prodhuese mund të interpretohen në mënyra të veçanta.
2. Terma të krijuara Brenda fushës, por që shërbejnë edhe si elemente të termave togfjalësh, si: rrokjeformues-e, (element rrokjeformues), drejtshkrimor-e, derjtshqiptimor-e, alveodhëmbor-e. Edhe për këta terma mund të shihet vetëm si zberthim formal, sepse nga pikëpamja e motivimit ato mund të shihen edhe si kompozita, por edhe si formime parashtesore.
3. Kompozita të formuara brenda fushës, por që, të përdorura brenda saj, zberthehen me elemente formale si kompozitat, si: kundërvënie, frymëmarrje, mbilaring etj.

Në grupin e kompozitave mund të futen edhe një grup termash të krijuar mbi bazën e përemrave një, dy, shumë etj., si: njërrrokësh-e, dyrrrokësh-e, shumërrrokësh-e. Janë më shumë si elemente termash. Sikurse edhe për formimet me prapashtesa, ashtu edhe për termat kompozita duhet theksuar se shfrytëzimi i mjeteve fjalëformuese shqipe dhe brumi leksikor shqip, si edhe gjedhet shqipe ka çuar në zëvendësimin e disa termave të huaj, si: ortoepi - drejtshqiptim, ortografi - drejtshkrim, ortoepik – drejtshqiptimor, - opozicion - kundërvënie, distiktiv – kuptimdallues, alveo-dental – qiellzo-dhëmbor etj.

4. RRUGA SINTAKSORE

Rruga sintaksore ka mjaft rëndësi në formimin e togfjalëshave të qëndrueshëm terminologjikë⁵, të cilët përbëjnë pjesën më të madhe për nga ana sasiore të termave të fonetikës. Shtimi gjithnjë e më i madh i termave togfjalësh, krahas atyre njëfjalësh, përbën një dukuri mjaft të përhapur në gjuhën letrare shqipe⁶.

Termet togfjalësh janë formuar mbi bazën e termave njëfjalësh, prandaj këta të fundit janë parësor para togfjalëshave terminologjikë. Megjithatë, togfjalëshat terminologjikë janë pjesë përbërëse e rëndësishme e leksikut terminologjik, e pasurojnë atë, krahas mjeteve të tjera fjalëformuese. Në fushën e fonetikës ka shumë rëndësi përdorimi i tyre. Nga ana sasiore

⁵ H. Pasho, "Togfjalëshat e zgjeruar emërorë në terminologjinë e ekonomisë", Sf.1985,

⁶ H. Pasho, shih 17

termat togfjalësh kanë ardhur duke u shtuar, p.sh. te S. Frashëri mbizotërojnë termat njëfjalësh; nga rreth 20 terma, 7 janë togfjalësh. Te A. Xhuvani nga rreth 15 terma, rreth 8 janë togfjalësh. Tek I. D. Sheperi nga rreth 47 terma, 27 janë togfjalësh, kurse 6 terma janë të fushës së anatomisë.

Tek “Fjalori terminologjik” nga rreth 3600 terma rreth 3000 janë togfjalësh .Pra, siç shihet, mbizotërojnë termat togfjalësh në pjesën më të madhe. Shumica e këtyre termave janë formuar nga dy fjalë dhe në bazë të tyre, si element bazë, është një term kyç, rreth të cilit grupohen termat togfjalësh. Përdorimi i togfjalëshave terminologjikë i jep terminologjisë së karakter sistemor dhe hierarkik, si p.sh.: tingull dhe tingull zanor, tingull rrokjeformues, tingull hundor, tingull I mbyllët, tingull i frymtuar etj.; zanore dhe zanore e mprehtë, zanore e gjatë, zanore e mesme, zanore hundore etj. Mbi bazën e këtyre termave dyfjalësh ndërtohen termat me më shumë se dy fjalë, të cilët e përforcojnë më tepër karakterin sistemor të kësaj terminologjie. P.sh.: bashkëtingëllore n → bashkëtingëllore mbylltore → bashkëtingëllore mbylltore e shurdhët; zanore → zanore themelore → zanore themelore e ngritjes së lartë etj. Me interes është të shikohet ndërtimi i termave togfjalësh nga ana leksikore e elementeve përbërëse të tyre, nëse janë terma apo fjalë të zakonshme, gjithashtu edhe nga ana e përbërjes leksiko-gramatikore të tyre. Mund të dallojmë këto lloje lidhjesh:

1. fjalë + fjalë

Rastet kur të dy elementet përbërëse të termit janë fjalë të zakonshme, janë raste të rralla në terminologjinë e fonetikës dhe është e vështirë të dallosh nëse njëri nga elementet përbërës të togfjalëshit është fjalë e zakonshme apo term, p.sh.: tipare dalluese, tipare tepruese, variante të lira etj.

2. fjalë + term

Edhe ky kombinim takohet në terminologjinë e fonetikës. Elementi i parë përbërës mund të jetë i leksikut të përgjithshëm ose një term që përdoret në fusha të tjera. Përmendim këtu: pikë zanore, njësi tingullore, mjetet tingullore (të gjuhës), njësitë gjuhësore, dallim fonemor etj.

3. term + fjalë

Ky lloj kombinimi haset më shpesh se dy rastet para, sepse si element i parë bazë del një term, i cili shërben për formime të shumta. P.sh.: zanore qendrore, ton i lartë, zanore të rënda, zanore të thjeshta etj.

4. term + term

Kombinimi term + term është një nga rastet më të shpeshta, që haset në përdorimin e togfjalëshave në terminologjinë e fonetikës. Elementi i parë është elementi bazë, me të cilin lidhen terma të tjerë ose edhe fjalë të leksikut të përgjithshëm që janë ngritur në nivelin e termit në fushën e fonetikës, janë njëkuptimësuar. P.sh.: tinguj mbylltorë, tinguj hundorë, tinguj shtegorë, zanore difuze, zanore kompakte, zanore tematike, zanore rrënjore, bashkëtingëllore dhëmbore, bashkëtingëllore ndërthëmbore, bashkëtingëllore sonore, bashkëtingëllore grykore etj. Ndërtimet me togfjalësha mund të shihen edhe nga përbërja e

elementeve të tyre si kategori leksiko- gramatikore. Kështu që mund të dallojmë disa lloje lidhjesh themelore ndërmjet elementeve që përbëjnë togfjalëshat:

1. emër +emër

Edhe ky tip kombinimi takohet në terminologjinë e fonetikës, por në raste të pakta në numër. Kështu nga vjelja e materialit kemi hasur: këmbime zanoresh, togje tingujsh, pikë e nyjëtimimit, tejsat e zërit, hundorëzimi i zanoreve, ndërrimet (alternimt) e tingujve, variantet (alofonet) e fonemave etj.

2. emër + mbiemër

Ky lloj kombinimi është mbizotërues në terminologjinë e fonetikës. Elemnti i dytë i togfjalëshit terminologjik mund të jetë një mbiemër i prejardhur nga një emër, p.sh. buzor nga buzë, grykor nga grykë, qiellzor nga qiellzë etj., por mund të jetë edhe prejpjesor, si: e theksuar, e patheksuar, e hapur, e mbyllur etj.

Këtë lloj kombinimi mund ta ndajmë në dy nëngrupe:

a. emër + mbiemër prejemëror

b. emër + mbiemër prejpjesor

Për nëngrupin e parë përmendim: pikë zanore, njësi tingullore, tingull hundor, bashkëtingëllore dhëmbore, zanore qendrore etj.

Për nëngrupin e dytë përmendim bashkëtingëlloret e nyjëtuara, dyshkronjësha të përbëra, zanore e pashpëritur, (i, e) nyjëtuar, tingull i frymëtuar etj.

3. togfjalësha me kombinime të shumta

Këtu përmendim: tinguj me fillim mbylltor, zanoret e shkallëve të ndërmjetme të hapjes, pjesëmarrja e zërit në formimin e tingullit, variante të detyrueshme të së njëjtës fonemë, zanore të prapme të zhvendosura përpara, dybuzoret mbylltore të zhurmëta, tinguj të përfutuar nga dridhje ritmike ose joritmike, buzo-dhëmboret shtegore të zhurmëta, pjesëmarrja ose mospjesëmarrja e buzëve në nyjëtimin e zanoreve etj.

5. REFERENCA

1. Dodi, a. "Fonetika".b. "Rreth sistemit vokalik të shqipes", në Çështje të fonetikës, Tiranë, 1972.c. Kundërvëniet e zanoreve të shqipes sipas tipareve të tyre akustike; Sf. 1998/2
2. A. Duro, a. Fjala term dhe struktura semantike e fjalës shqipe", "SF. 1991.
3. A. Duro, Sistemet terminologjike në gjuhën e shkencës dhe të teknikës", Sf. 1984. 4;
4. A. Duro, "Termi dhe fjala në gjuhën shqipe", Tiranë, 2009
5. A. Duro, "Terminologjia si sistem", Tiranë, 2001
6. A. Xhuvani, "Libri i gjuhës a gramatikë", pjesa I, Elbasan, 1919
7. E. Lafe, Ndhimesa e N. Veqilharxhit në terminologjinë shqipe, në sf. 1986, 4
8. F. Leka, "Udhëzues për përpunimin e terminologjisë shkencore", Tiranë, 1983
9. F. Leka, "Aspekte të zhvillimit të terminologjisë tekniko- shkencore...", në

- “Studime mbi leksikon”, 1972
10. H. Pasho, a. “Zhvillimi i terminologjisë së ekonomisë...”, Sf. 1984. 1;
 11. J. Thomai, a. “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, Tiranë 2008. b. Prejardhja semantike në gjuhën shqipe; Tiranë,
 12. K. Topalli, “Shndërrime historike në sistemin zanor...”, tiranë, 2000
 13. S. Frashëri, “Shkronjëtorja”, në “S. Frashëri, Vepra 1”, tiranë, 1988
 14. Xh. Lloshi, a. “Stilistika dhe pragmatika”, Tiranë 2006. b. “Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe”, në “Studime mbi leksikon...”, pjesa I, tiranë, 1972
 15. “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1980.
 16. “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 2006